



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 159, datë 31.08.2023

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST- SHOQËRI ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË
PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22 e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e riemërimit të zj. Estela Koçi, zj. Vjosa Mujo dhe z. Eugen Nuri, si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Credins Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., për një mandat 3 vjeçar.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**